



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KATËR TË RREGULLT TË KUVENDIT KOMUNAL TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi z.Naim Pira, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 27.04.2016 (e Mërkurë) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje prezantuan 27 anëtarë të Kuvendit Komunal. Të pranishëm ishin nënkryetari i komunës, z.Hasan Aliu, drejtorët e drejtorive, zyra e OSBE-së, mjetet e informimit dhe zyrtarja e Zyrës Ligjore.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, andaj kemi kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi: Përhëndetje për nënkryetarin e Komunës, të gjithë ju anëtarë të KK-së si dhe ju të pranishëm, dhe mirë se keni ardhur në mbledhjen e katër të rregullt të KK-së.

Pasi bëri hapjen e mbledhjen, kryesuesi pyeti se a ka kush të thotë diçka para se të paraqesim rendin e ditës dhe ua kaloi fjalën anëtarëve të Kuvendit Komunal.

znj.Mirlinda Sadiku: Unë kam pyetje për Drejtorinë e Arsimit: Çfarë është duke ndodhur me bursat e studentëve?. E dyta ka të bëjë me Drejtorinë e Bujqësisë, është mirë që këtij kuvendi ti sillet një raport lidhur me investimet që i ka bërë fondacioni i Luksemburgut, kur e dimë se fondacioni ka participuar me 150 mijë euro, ndërsa komuna me 50 mijë euro. Drejtori sot nuk qenka këtu, por besoj që ia transmeton kryesuesi, që në seancën e radhës ta kemi një raport të kompletuar. Janë bërë disa ndryshime aty gjatë implementimit të projektit: Si ka qenë më herët, cilat janë bërë ndryshimet, pse janë bërë ndryshimet?, të na sillet një raport i detajuar. Ndërsa këtu kam një informacion, të cilin do të dëshiroja ta ndaja me ju kolegë të nderuar, pikërisht çështja që e kemi potencuar unë dhe z.Dauti në vitin e kaluar, kur kemi marr vesh që kemi rënie të buxhetit. Sipas një hulumtimi të institutit GAP, ku ministritë të cilat janë marr në këtë hulumtim janë Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit e Kulturës, e Administratës Publike si dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë. Sipas këtij hulumtimi rezulton se Vitisë iu kanë ndarë për kokë banori 16 euro e 50 cent, kurse nëse krahasohet me Kamenicën atje 44 euro e 2 cent, rrjedhimisht do të ishte mirë që edhe drejtori i Financave ta ketë si një argument të fort, që kur të shkon, kur bëhen ndarjet buxhetore ta ketë parasysh këtë hulumtim, sepse ka ndodhur ky diskriminim, ose përshembull në qoftë se e marrim edhe Komunën e Parteshit, Komuna e Parteshit i ka 57 euro e 50 cent për kokë banori. Mendoj se kjo nuk është në rregull që të diskriminohet Viti, kur e dimë se Ministria e Infrastrukturës, e Shëndetësisë e sidomos edhe ajo e Arsimit janë shumë ministri të

rëndësishme, pse të mos investohet edhe te ne kur jemi taksapagues të njëjtë sikurse të gjitha komunat tjera.

z.Sejdi Emini: Unë sot do ta ngrit një shqetësim të qytetarëve të komunës sonë e cila ka të bëj me autostradën e cila po ndërtohet dhe nuk po lihet kyçje hiç në Gërlicë, besoj që kjo bie mbi përgjegjësinë e të gjitha subjekteve politike, i tejkalon të gjithë kufijtë politik, është interes i përgjithshëm i qytetarëve tanë. Nëse në një vend nuk ka rrugë dhe nuk ka kyçje në autostradë e dimë që ai vend pothuajse është i vdekur, ashtu kështu Vitia ka qenë zorrë qorre, kemi Malishevën që i ka dy kyçje, ashtu dhe Suharekën, kurse ne diku rreth 70 mijë banorë dhe mos të kemi kyçje, mendoj që është përgjegjësi e të gjithë atyre që e kanë marr votën e qytetarëve të Komunës së Vitisë. Unë jam i mendimit që të gjithë bashkërisht të gjejmë formën, të bëjmë presionin dhe ta arrijmë qëllimin i cili do të jetë jetik për Komunën e Vitisë, i kalojmë të gjithë kufijtë politik, i lëmë anash, duke filluar nga kryetari e deputeti, asamblistët e të gjithë ne së bashku mundemi të bëjmë këtë, prandaj mos t'ia lëmë kohës, sepse gjeneratat e ardhshme do të na pyesin pse është kjo mungesë. Kërkoj edhe njëherë shumë sinqerisht, që bashkërisht nëse është e nevojshme edhe të dalim në rrugë atje në Gërlicë, të protestojmë derisa ta arrijmë qëllimin, i cili është shumë i rëndësishëm për neve si qytetarë të kësaj komune.

z.Samet Idrizi: Unë jam këtu për ti ngritur disa çështje që i preokupojnë qytetarët. Siç e dimë vitin e kaluar i kemi vendosur tabelat që tregojnë rrugët dhe institucionet, ka gabime që janë bërë gjatë shkrimit, kam një kërkesë prej qytetarëve të një lagje të fshatit Ramjan, aty tabela është shkruar vetëm Azemi edhe pse qytetarët e asaj lagje kanë bërë ftesë të shkruhet Haxhi Azemi ose familja Azemi, në mënyrë që të afërmit e tyre të orientohen më mirë, domethënë është mirë me shënuar dhe me përmirësuar, nuk është vetëm ky lëshim, por edhe lëshime tjera që qytetarët kanë kërkuar që të rishkruhen. Tjetër, desha të ndërlihem pak me subvencionet në bujqësi, si porosi ose kërkesë është që Drejtoria e Bujqësisë në bashkëpunim me instancat e larta qendrore të Ministrisë së Bujqësisë të kenë parasysh kur bëjnë ndarjen e subvencioneve, personalisht kam parë 3-4 serra të mëdha diku që janë me 5-10 ari, që janë vendosur dhe kurrë nuk kanë hy në funksion, qëllimi i gjithë kësaj është që komisioni kur të vendos për këto çështje të din kujt të ia ndaj këtë donacion se janë ndarë donacione të tilla dhe nuk janë në funksion të qytetarëve, domethënë i janë dhënë njerëzve të cilët nuk janë duke i shfrytëzuar për të prodhuar produkte aty. Tjetra, janë bërë trotuare nëpër Viti, edhe në qeverinë e kaluar edhe në këtë qeveri që po hyn në vitin e tretë, mirëpo nevoja më e madhe e ndërtimit të trotuareve është prej te shkolla e mesme, te ura aty që shkon për Beguncë deri te Lindi, ku ka mbetur aty përpara shumë keq, unë personalisht e kam shikuar rrugën aty ka mjaftueshëm vend për ti bërë dy trotuare dhe prapë ka mundësi dy vetura të kalojnë, është mirë qeveria lokale ta merr këtë seriozisht dhe të investohet aty urgjent, sepse unë kam parë aty nxënësit duke kaluar se aty bëhet një frekuentim që mundet të ketë shumë pasoja, në fund të fundit nxënësit janë në rrugë, veturat, kamionët. Ju kisha lutur edhe njëherë, megjithëse e kam bërë këtë ftesë edhe më herët që ajo rrugë të rregullohet me dy trotuare, sepse ka mundësi dhe hapësirë dhe unë nuk e di nëse një qeveri lokale nuk ka mundësi 8 metra ti shpronësoj para "Lindit" me një metër trotuar dhe me mbet ashtu qe 8 vite përnjëmend nuk kemi as kuvend, as qeveri edhe unë bëj ftesë që aty kuvendi me u marr dhe ne e shpronësojmë atë pjesë ia kompensojmë dhe e bëjmë trotuarin, kaq kemi mundësi të bëjmë.

z.Bekim Azizi: Unë me fillim kisha bërë një pyetje te ky asfalti në Tërpezë, që është duke u meremetuar, që është shtruar para 3-4 muajve, që u bëmë horë me këtë asfalt edhe me të gjitha mjetet e informimit, që edhe me një debat që e kemi pasur me Jeta në Komunë, Samiu

dhe kryetari thoshin se jeni duke i publikuar disa fotografi që kanë qenë prej rrugëve të kaluara, tash po shihet se gjysma e asfaltit tashmë është hequr dhe nuk di çfarë është duke u bërë aty, a është marr ndonjë masë ndaj atyre që kanë pranuar atë pjesë të punës të kryer që janë lëshuar një pjesë e mirë e parave, a është bërë inicim në prokurori këto shkelje e dëmtime që janë bërë apo aq shumë jeni të përlyer në këtë rrugë sa që nuk po guxoni të bëni zë e duhet ti fshehni disa gjëra: Ku është ky problem?. Unë mendoj se ia vlen të diskutohet, ia vlen të sillet tamam një raport se çfarë është duke ndodhur me këtë rrugë. Tjetra çështje që do të kyçem, i shoh lumin “Morava” janë duke e pastruar 3 bagera, a ka pasur tender për këtë apo me çfarë marrëveshje merret ai dhe prej aty dhe shitet, kamionët marrin dhe shesin dhe, me çfarë marrëveshje lejohet ajo, unë e di që është e ndaluar me u marr ai dhe dhe të bëhet tregti me të. Pyetjen tjetër ia kisha bërë drejtorit të Arsimit, Drejtor, në shkollën teknike është duke u mbajtur një turnir i nxënësve, 50 klasë janë në shkollë, topa nuk kanë pasur ta mbajnë turnirin, domethënë i kanë huazuar tjetërkund, pse mos të kemi topa kur e dimë dhe është diskutuar shumë herë se 60 euro një top, pse topa mos të ketë shkolla teknike, asnjë nuk ka ardhur këtë vit dhe topa kanë gjetur tjetërkund për ta mbajtur një turnir nxënësit në shkollë, kjo është shumë e vërtetë.

z.Vehbi Rama. Ne si Komitet për Komunitete, së bashku me kolegun Bislimi, kemi vizituar komunitetin kroat në Letnicë, ata janë në gjendje thuaj se të mjerueshme, në gjendje të rëndë sociale, nuk kanë kushte jetësore për jetesë, përpos që marrin një pagë nga institucioni i Republikës sonë, një pension. Komiteti për Komunitete rekomandon që të përmirësoj kushtet e tyre, ata kërkojnë që mjeku ti vizitoj më shpesh, sepse është një herë në javë tekniku, ata kërkojnë që të jetë rregullisht mjeku, sepse kanë nevojë, t’iu sigurohet një minibarnatore, të ju rregullohet ndonjë dhomë, sepse këta detyrohen për shkak të kushteve të vështira të shkojnë në katin e dytë të marrin ushqimin, sepse dhoma poshtë është e pa banueshme dhe shujtën që e kanë kuzhinën popullore e marri vetëm këtë shujtë për 24 orë, kështu që rekomandojmë që të kenë një transport Viti-Letnicë dhe anasjelltas, mirëpo këto janë vetëm disa kushte elementare që ata kanë nevojë urgjente. Unë mendoj që duhet të dërgohet një ekip special nga ky kuvend që të intervenohet apo të bëj vlerësimin në mënyrë se çka iu nevojitet më tepër.

z.Nuredin Lutfiu: Unë kam një kërkesë për drejtorin e Inspektionit nga taksitët, minikombit, të cilët operojnë për Gjilan. Kur shkojnë në Gjilan pengohen nga inspektorat e Komunës së Gjilanit, vetëm kanë të drejtë ti zbarkojnë udhëtarët, kurse nuk kanë të drejtë të marrin asnjë udhëtar kënde, minitaksitë e Gjilanit të cilët operojnë në Viti vijnë këtu dhe i marrin udhëtarët, taksitë e Vitisë kërkojnë nga inspektorati të ndërhyj në këtë çështje.

z.Ali Bajrami: Kisha dashur vetëm disa fjalë për mbështetjen dhe përkrahjen, një falënderim Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Drejtorisë së Urbanizmit, shoqatës “Ta pastrojmë Kosovën” dhe “Eco-Higjienës” për kontributin që e kanë dhënë në eliminimin e deponive të egra në fshatin Goshicë. Vërtetë aty është bërë një punë e madhe, është pastruar pjesa dërmuese, ka mbetur një pjesë që na mbetet në të ardhmen të shikojmë mundësitë edhe materiale edhe të transportit që ti eliminojmë në tërësi, se është bërë kënaqësi të shihet ajo pjesë që është pastruar në çfarë gjendje të mirë dhe është tash në shërbim të qytetarëve. Tjetër çka kisha dashur të përmendi në bazë të raportit të auditorit të përgjithshëm, sa i përket investimeve kapitale, Komuna e Vitisë është radhitur e para në shpenzim të buxhetit me 97%, që këtu vlen të përgëzohen edhe kryetari edhe drejtorët edhe ne si asamble komunale, që me votën tonë i kemi kontribuar një përqindje të tillë.

znj.Majlinda Ostrogllava: Këtë çështje e kam ngritur edhe në shumë seanca tjera, duke e ditur faktin se ekziston vetëm një çerdhe publike në komunën tonë, kisha dashur ta di nga

drejtori i Arsimit se ku qëndron problemi, sepse ka premtuar në vitin e kaluar se do të bëhet një çerdhe e re, Drejtor, ku qëndron problemi?, nëse është nevoja do të japim edhe këshilla ne si opozitë.

z.Bislim Bislimaj: Edhe unë desha të ndërlihem me z.Vehbiun, ne si komitet kemi qenë në Letnicë dhe e vizituam atë komunitet, i cili është në gjendje shumë të rëndë, kemi raste edhe në kushte edhe më të këqija, nuk është si arsye e problemeve tona, ata kanë pasur probleme të veta, sepse janë braktis nga familjarët e tyre, janë pleq, por është humanizëm ne të intervenojmë që të bëjmë kushtet minimale për të jetuar një jetë të dinjitetshme. Mendoj se kemi mundësi ta bëjmë, disa kërkesa që ata na i shtruan, një 2-3 familje kishin nevojë urgjente për një dhomë për të pasur një jetë normale, një tjetër familje mendohej ta mbante biznesin, kishin livadhe, por nuk kishin me çka ti kosisin, duhet të iu ndihmuar në këtë aspekt. Nuk janë kërkesa të mëdha, por është në nderin tonë të jua mundësojmë një jetë normale. Edhe një problem tjetër që është duke na shqetësuar edhe neve edhe qytetarët është çështja e sallës sportive në Drobesh, që keni premtuar ta ndërtoni, ne nuk kemi parë asnjë lëvizje në këtë drejtim, por do të ishte mirë ju të na informoni. Problemi i mbeturinave, që e përmendi z.Ali, ai kontribut është një herë në vit, por duhet të krijohet një shprehje që ato mbeturina qytetarët mos ti hedhin, është vërejt një fenomen që po i hedhin jashtë qytetit, jashtë fshatrave nëpër lumenj ose nëpër pyje, që çdo vit e më tepër po shtohen këto dukuri. Është mirë që ne po dalim e po pastrojmë çdo vit, por qytetarët nuk po vetëdijesohen pa ndërhyrje të inspektoratit.

z.Sejdi Emini: Unë po detyrohem për hir të vërtetës ndonjëherë të dal dhe me thënë atë se nuk po mundem ta mbaj brenda, jam i tillë për nga natyra, karakterin nuk mundem ta ndryshoj pas tërë këtyre viteve që kam. Ajo që tha z.Aliu është e vërtetë që e kemi pastruar bashkërisht, shoqërisht pa dallime politike, por më së paku na ka ndihmuar komuna, ia kemi kërkuar një kamion që të vij ti bart mbeturinat nuk kanë mundur të na e ofroj, nuk ka pasur kushte, ka thënë nuk kam mjete, atë e kemi bërë ne me organizatën “Ta pastrojmë Kosovën”, një banor Gëzim Metallari, që e falënderojmë shumë, jo vetëm kësaj here por çdo herë po e qet bagerin dhe po na përgjigjet, kështu që komuna nuk na ka ndihmuar, kur të na ndihmon e falënderojmë, e respektojmë, mirëpo kësaj here nuk na ka ndihmuar. Kjo është gjendja reale pos që kanë ardhur pak moralisht të na përkrahin.

znj.Besjana Rexhepi: Pata një lloj kërkesë, është pak si me thënë e ndjeshme, por duhet të zgjidhet, e dimë që ka kategori të ndryshme dëmtimesh të nxënësve, nxënës që nuk vizitohen nga institucionet komunale për faktin se janë të mbyllur në shtëpitë e tyre, mos ti quajmë më mirë me thënë fëmijë të retarduar, kështu që kisha kërkuar nga institucionet komunale të organizohet një lloj debati publik me familjet e shumta, të cilët këta fëmijë i mbajnë të mbyllur në shtëpitë e tyre, këta fëmijë janë me dëmtime mentale dhe e dimë që disa familje ende kanë lloj hezitimi, sepse mendojnë që është turp i familjes ai fëmijë, mirëpo besoj që nëse institucionet komunale organizojnë debate, atëherë këto familje do të binden dhe bëhet përmasimi i këtyre fëmijëve.

z.Sami Demelezi: Unë dola kësaj here këtu për një kundërshti ndaj kryesuesit, se nuk shkelet rregullorja për të na bërë qefin neve, qofshim pozitiv apo negativ, prandaj të shkelet rregullorja pse dikush po dëshiron të dal në foltore 3 herë dhe në ndërkohë meqë dola propozoj që kjo pikë e rendit të ditës të jetë për në fund çdo herë e jo e para se paksa po na konsumon, mirë është që të vazhdojmë me rendin e ditës dhe krejt në fund ta kemi këtë rend të ditës, prandaj propozoj që kryesuesi këtë propozim timin ta qet në votim.

z.Daut Xhemajli: Pasi që Samiu propozoj që të qitet si pikë e fundit të ndryshme, por është një problem që e kemi me rregullore dhe është një çështje tjetër që mund të mbetet kjo si

pikë, por duhet të ketë vetëm pyetje dhe propozime jo diskutime për çdo çështje të ndryshme, tash mundet të mbetet ndonjë pyetje, por jo të diskutohet për të gjitha problemet që ka Vitia ose që mundet të diskutohen, në këtë aspekt është që ta shtojmë të ndryshme, por kjo si pikë duhet të mbetet si ndonjë pyetje ose propozim. Këtë kuptim unë e miratoj që ta shtojmë një pikë standarde të ndryshme, ku secili këshilltar ka të drejtë të parashtroj çdo çështje që ai e konsideron se duhet të debatohet dhe e kufizojmë kohën e këtij diskutimi.

z.Samet Idriz: Unë dhe grupi i PDK-së konsiderojmë që nuk ka asnjë kuptim që kjo të ndryshme të jetë në fund, unë mendoj që në këtë parapikën ku po diskutohen çështje të ndryshme që janë të rëndësishme për qytetarë edhe vetëm është mirë që kryesuesi të jetë më në nivel në detyrën e tij konform rregullores.

z.Bislim Bislimi: Unë mendoj që ne mund edhe ta heqim këtë pikë të rendit të ditës, por jam i bindur që ajo që iu nevojitet qytetarëve është pikërisht kjo pika para rendit të ditës, aty po shqyrtohen të gjitha problemet dhe kryesuesi përmes këtyre pikave mund ta formojnë rendin e ditës për një seancë për ti shqyrtuar këto probleme.

z.Ekrem Abazi: Unë mendoj që kjo pikë e rendit të ditës pyetje, përgjigje ose të ndryshme të jetë pikë e parë e rendit të ditës, për shkak se drejtorët në fillim janë të gjithë këtu, pasdite ju po e shihni se as këshilltarët nuk rrinë e lëre më këshilltarët e kryetarit. Për këtë arsye propozoj që kjo pikë të jetë pikë e parë e rendit të ditës, pyetje, përgjigje ose të ndryshme dhe propozimi im është që koha të kufizohet në 30 minuta.

Kryesuesi. E marrim parasysh propozimin e z.Samiut dhe z.Sametit, andaj e hedhim në votim: Kush është që debati të zhvillohet pas rendit të ditës?. Konstatohet se kjo pikë të jetë pikë e parë e rendit të ditës dhe nuk mund të zgjatet më shumë se 30 minuta.

I japim fjalën nënkryetarit meqë u parashtruan një numër pyetjesh.

z.Hasan Aliu: Unë nuk e konsideroj këtë pikë të rendit të ditës, por si debat të kuvendit ku parashtrohen pyetje për çështje të ndryshme.

Çështjen e bursave ju e dini, e keni votuar buxhetin, do të shohim mundësinë që në afatin sa është mundësia dhe ajo ndarje që të bëhet ajo. Unë konsideroj që çështjen që e shtrove një raport nga drejtoria për Kosovë-Luksemburg për subvencionimin që e kanë bërë, nuk ka problem, do ta kesh edhe raportin. Shumë me vend e shtron çështjen Sejda, mirëpo ajo është kompetencë e nivelit qendror, por përpjekjet tona duhet të jenë maksimale që të ketë një kyçje, vetëm nuk pajtohem me atë që të protestojmë se protesta është si mjet i fundit. Çështja e tabelave, si janë aprovuar nga Kuvendi në atë formë janë dërguar, por do të shohim dhe ti diskutojmë dhe korrigjojmë gjitha lëshimet, sepse është në të mirë të qytetarëve. Çështjet e shpronësimit janë telashe që nga e kaluara, megjithatë nuk është e lehtë për shkak të potencialit buxhetor që e ka Komuna e Vitisë, por e dimë që ka kaluar projekti Demos-Kosova që do të trajtoj këto çështje të trotuareve, duke filluar nga “Lindi i ri” dhe me të vërtetë do ti krijojmë hapësirat më të mira për qytetarët dhe nxënësit. Te çështja e serrave, ju si doni mund ta shtroni, pajtohem edhe unë të funksionalizohet ajo që u është dhënë si subvencion, por të gjitha ato që ndahen nga qeveria, Drejtoria e Bujqësisë nuk ka çasje në to. Asfalti është e vërtetë që është brengë e qeverisjes aktuale, por nuk më pëlqen ajo shprehja është përlyer dikush, dua ta di kush është në këtë sërë bashku me ty Bekim ta dërgojmë në prokurori. Ne i kemi bërë disa ndërhyrje atje në kuzhinë, por do të mundohemi që të intervenojmë sipas mundësisë më tepër, tash ti sigurohet transporti i rregullt është pak problem, megjithatë punë e shkëlqyeshme dhe rekomandimet janë në nivel. Çështja e taksistëve është e vërtetë lidhur me atë, ata në kuadër të ligjit e kanë nxjerr rregullore dhe kanë të drejtë, shumë herë kam kërkuar masën e reciprocitetit.

Çështja në Goshicë që është bërë është për tu përshëndetur dhe komuna ka kontribuar në bazë të mundësive. Çështja e çerdhes është një nevojë imediate, ju e dini që është shqyrtuar edhe një mundësi e ndërrimit, me siguri e dini se e lejon edhe ligji, por gjithsesi do të shikojmë ta bëjmë, sepse është një nevojë se Vitia duhet të ketë edhe një çerdhe.

z.Nexhmedin Jakupi: Nuk u pajtova me një pjesë të diskutimit të këshilltarit i cili tha se komuna nuk ka ndihmuar në asnjë formë aktivitetit që është zhvilluar në Goshicë, në pastrimin e ambientit, përkundrazi komuna nëpërmes kompanisë “Ecohigjiena” ka pasur në atë aktivitet 10-12 punëtorë ku kemi qenë edhe një pjesë e drejtorëve dhe i kemi vizituar e kemi marr pjesë në pastrim të ambientit, disa prej neve dhe kemi arritur ta sjellim edhe organizatën “Ta pastrojmë Kosovën”. Kjo është meritë e zyrtarëve të komunës, kaq kemi pasur mundësi.

Kryesuesi: Ju falënderoj të gjithëve për kontributin që dhatë rreth pyetjeve dhe propozimeve.

Për seancën e katërt të rregullt të kuvendit komunal të Vitisë kemi paraparë këtë

REND DITE

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e KK-së.
2. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar-mars 2016.
3. Shqyrtimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 100.203 euro për përfundimin e projektit ndërtimi i sistemit të ujësjellësit në fshatrat Sllatinë e Epërme, Sllatinë e Poshtme, Sodovinë e Qerkezëve, Sodovinë e Jerlive dhe Trestenik të Komunës së Vitisë.
4. Propozim vendim për miratimin e planit komunal për efikasitet të energjisë 2016-2020.
5. Propozim vendim për formimin e Komitetit për Barazi Gjinore.

A ka dikush rreth rendit të ditës? Nëse nuk ka atëherë e hedhim në votim për miratim: Kush është që të miratohet ky rend dite? Konstatohet se me vota unanime miratohet ky rend dite.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e KK-së

A ka ndonjë vërejtje dikush rreth kësaj pike të rendit të ditës? Meqë nuk ka e hedhim në votim. Kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Konstatohet se me vota unanime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar-mars 2016

I japim fjalën drejtorit të drejtorisë përkatëse për sqarime shtesë.

z.Ibrahim Rama: Pasqyrat financiare gjithmonë përpilohen në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, dhe në bazë të Statutit të Komunës së Vitisë. Gjithsej buxheti komunal i aprovuar për vitin 2016 është 9 milion e 564 mijë e 530 euro, nga ky fond për 3 muajt e parë të vitit 2016 janë alokuar 2 milion e 480 mijë e 372 euro dhe nga kjo shumë buxheti është shpenzuar 1 milion e 969 mijë e 787 euro apo shkrehur në përqindje prej 79,41%. Materialin e keni pranuar me kohë, e keni para vetes. Për pyetje, sqarim e vërejtje jam në dispozicionin tuaj.

Kryesuesi. Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: Kush do ta merr fjalën?

znj.Vjollca Kadolli-Halili: Sot para vetes i kemi pasqyrat financiare janar-mars 2016, domethënë raportin 3 mujor, të cilat i kemi të paraqitura të hyrat vetanake, shpenzimet dhe investimet për një periudhë të kaluar. Paraprakisht edhe unë kisha përgëzuar drejtorin, që çdo

herë që dy vite e gjysmë ka qenë korrekt dhe i ka sjell para nesh pasqyrat financiare në afatin e caktuar kohorë, do të thotë 4 herë brenda vitit. Nga analizat që ne i kemi bërë këtyre pasqyrave mendoj se realizimi i planit nga të gjitha drejtoritë diku 90% tregon për një punë dhe përkushtim serioz të secilës drejtori, me përjashtim ku dihet për përgjegjësitë që ka Drejtoria e Financave dhe shpenzimi i buxhetit zakonisht bëhet në 3-mujorët e tjerë. Edhe te investimet kapitale ato shihen që janë më të larta në krahasim me vitin e kaluar, megjithatë 3 mujori i parë karakterizohet me një fazë më të ulët të investimit për shkak të procedurave të prokurimit dhe tenderimit, kurse sa i përket të hyrave vetanake mendoj se shihet një përmirësim në këtë aspekt, ku vetëm për periudhën 3-mujore kemi një rritje prej 9.27% dhe shpresojmë që kjo rritje të jetë edhe më e madhe në fazat tjera, gjithashtu rritje ka edhe te donatorët në krahasim me vitin e kaluar, ku kemi afro 60 mijë euro të fituara këtë vit dhe e përgëzojmë qeverinë komunale, që të ndikoj sa më shumë në thithjen e donacioneve nga vendet tjera.

z.Samet Idrizi: E falënderojmë drejtorin e Financave për ofrimin e pasqyrave financiare 3-mujore, megjithëse ky tha më herët është detyrim ligjor me i pasqyruar këto. Kisha një vërejtje të vogël për kryetaren e grupit të LDK-së, kur pasqyrat financiare paraqesin edhe planifikimin sa ka qenë i mirë apo jo, unë e pash këtu, nuk ka qenë i mirë planifikimi vjetor, mendoj që Vjollca duhet me qenë më profesionale dhe të jep kritikë pozitive po edhe negative për pasqyrat financiare, se kjo është në fund të fundit përgjegjësi e saj që jo vetëm ta lavdëroj punën dhe pasqyrat financiare, aty ku ka vend për kritikë të kritikoj. Unë kisha filluar me disa zëra këtu, shpenzimet e rrymës mendoj se janë rritur, por besoj se drejtori financiar na jep sqarime, edhe shpenzimet e ujit janë rritur karshi 3-mujorit të kaluar, të paktën ashtu si janë pasqyruar, ndonjëherë ndodh të ketë lëshime teknike, pastaj jemi te faqja e 3, është vazhduar me shpenzime të ndryshme shëndetësore, shpenzime kontraktuese tjera, shërbimet teknike. Ne kemi kërkuar që këto të pasqyrohen të paktën me një vërejtje në fund të faqes, që ta dimë se çka, sigurisht po konsideroj se këto janë shpenzime të drejta. Kodi 13501 mobilie, ne edhe vitin e kaluar kemi blerë mobilie, edhe këtë vit përafërsisht njëjtë, është mirë të dihet nga ne a janë blerë për shkollë a për administratë, nëse për çdo vit blejmë mobilie nga 20 mijë euro, 23 mijë, është vërtetë shumë për ekonominë tonë. Investimet kapitale janë tejte të ulëta, është një arsye aty te procedurat e prokurimit, megjithatë unë mendoj se kanë mundur të jenë më të larta se jemi shumë poshtë dhe kur po hymë në 3-mujorin e dytë po shfaqen ndryshime, investimet po shkojnë në kohën shtator-nëntor, në kohën më të keqe për investime, sidomos në asfaltim të rrugëve, por edhe ndërtimin e objekteve. Faqe 19, të hyrat buxhetore komunale vetanake të planifikuara dhe realizuara për periudhën janar-mars 2016, më herët ku thash se pasqyrat financiare paraqesin edhe planifikimin sa kemi qenë në planifikim të saktë, kemi te lejet urbanistike, kemi planifikuar shumë lartë këtë 3-mujor, jemi shumë poshtë diku kemi realizuar vetëm 10.33%, nuk e di se çka është duke ndodhur, është mirë që drejtoria përkatëse të fokusohet më shumë edhe në planifikim me qenë më real, por edhe më e angazhuar në punë. Po ashtu të hyra nga qiraja objektet shëndetësore është një planifikim që nuk është realizuar, unë mendoj kur bëhet fjalë për qiranë ai duhet të realizohet 100%, se tash e ke instrumentin në dorë, në momentin që operatori nuk ta paguan borxhin ti mundesh të ia ndërpresësh kontratën. Te parkingjet publike, shfrytëzimi i hapësirave publike po ashtu edhe këtu është planifikuar 8400 euro, është realizuar vetëm 184 euro, 8.76 % edhe këtu një planifikim jo i mirë, po ashtu te taksat komunale për biznes planifikohet 4500 euro të vjelën komplet vitin, por realizimi i 3-mujorit 8.44% është shumë poshtë. Donacionet, edhe unë jam shumë i gëzuar si qytetar i këtij vendi që kemi donacione 58 mijë euro në 3-mujorin e parë, por me sa e kam vërejtur zakonisht donacionet vetëm përfitohen në 6-mujorin e parë të këtij

viti, dhe unë mendoj që kjo vlerë është e ulët, është vështirë tash të kemi donacione tjera gjatë vitit, se këto zakonisht në fillim të viti bëhen. Të hyrat nga qiraja e objekteve shëndetësore 2880 euro të hyrat në 2016 janë më të ulëta, nuk di pse, një krahasim i vetëm, edhe shkojmë faqe 25 krahasimi i shpenzimeve në vitin 2016 me të njëjtën periudhë të vitit 2015, sigurisht këtu më korrigjoni edhe jep sqarime drejtori i Financave, shpenzimet e viti 2015, kodi 13130, shpenzimet e udhëtimit brenda vendit, shpenzimet janë 2947 euro, obligimet 31095 euro, domethënë obligimet janë më të larta se shpenzimet, tash këtu ose është bart një vlerë prej 2014 - 2015 dhe del në 2016 ose është bërë ndonjë gabim, nëse unë jam gabim kisha dashur të më korrigjoj drejtori i Financave. Këto pozicione i kemi në disa vende, e kemi për shembull te shpenzimi i mbeturinave, shpenzimet viti 2015 janë 278 euro, obligimet 758 euro, nuk mund të jenë tash obligimet më të mëdha se shpenzimet, se shpenzimet i përcaktojnë obligimet, këtu e kemi kodin 13509 pajisje tjera, shpenzimet janë 38 mijë e 360 obligimet 1800 euro, këtu është mirë domethënë është bartur ajo pjesa çka ka mbetur, edhe në disa vende i kemi me zero furnizime pastrimi 13640 shpenzimet zero, obligimet 4039 euro e kështu me radhë. Unë nuk kam tjetër, por besoj se drejtori e kontrollon faqe 25 dhe 26 te krahasimi i shpenzimeve dhe obligimeve viti 2015 dhe 2016.

z.Ekrem Abazi: Desha disa sqarime prej drejtorit për Financa, për shembull shërbime kontraktuese tjera janë 10 mijë e 973 euro, mobilie 23 mijë e 10 euro, pajisje tjera 5779 euro, furnizim për zyre 9447 euro, mirëmbajtja e ndërtesave 17 mijë e 373 euro, fatkeqësisht mirëmbajtja e shkollave 373 euro. Këto shifrat janë, shuma tyre është, por desha ndonjë sqarim më të detajuar për këto ose në mënyrë tabelare, çka janë këto, ku janë harxhuar këto ose ndonjë sqarim më të detajuar, këto janë të zakonshme që po përsëriten, sepse nuk ka sqarime ku janë harxhuar. Sa i përket harxhimeve të përgjithshme, shërbime dhe mallra, mirë që kishit kursyer pak para, por te shëndetësia dhe çështje sociale është dashur të shpenzohen 100% se pak kanë qenë, ishte harxhuar 75%, sepse aty ka nevojë për gjithçka. Sa i përket investimeve kapitale 3.10%, e di që janë procedurat e tenderimit, por kisha një kërkesë që dy etapet, etapën e dytë dhe tretë që të shpenzohen më shumë për investime kapitale, mos të lihen në etapën e katërt ose pak para vitit të ri kur bie edhe borë, se gjithmonë shpenzimet po bëhen për investime kapitale në muajin nëntor dhe dhjetor, kur nuk është koha e përshtatshme, por etapën e dytë mund të punohen të gjitha investimet kapitale.

z.Ali Bajrami: Para se të filloj kisha filluar me atë thënien e vjetër “dita e mirë shihet në mëngjes”, atëherë këtu në faqen e parë është pikërisht kjo që po dua të them, te të hyrat që kemi një rritje të të hyrave kapitale vetanake, nuk është shumë e madhe, por është trend pozitiv që do të shkon në rritje të vazhdueshme, vlera prej 9.27% është një vlerë inkurajuese, që na bën optimist dhe na e rrit vetëbesimin për të vazhduar në rritjen e të hyrave vetanake në mënyrë të koordinuar edhe në tre muajorët e tjerë në vazhdim. Shpenzimet buxhetore ato që ne i kemi votuar, mjetet të alokuara dhe shpenzuara shikuar në përqindje prej 79.41%. Shpenzimet e buxhetit nëpër të gjitha njësitë buxhetore kanë një përqindje mbi 80%, që është përqindje e mirë e shpenzimit të buxhetit. Ajo që vlen të përhëndetet është te kodi 13503, kompjuter që janë blerë për nevoja të administratës dhe zyrave komunale, për shpenzime të mbeturinave te kodi 13230 e kemi një vlerë afër 3000 euro, që është për tu përhëndetur, se me këtë e pastrojmë ambientin. Kodi 14032, mirëmbajtja e auto rrugëve lokale, që është 23643 euro edhe këtë është krejt për të mirën e qytetarëve të komunës, tjetër që kisha me potencuar që e përmenden edhe para folësit donacionet janë afër 60 mijë euro, që është mirë dhe duhet të bëhen përpjekje që të rriten donacionet, se janë përfitime ekstra jashtë buxhetit që munden ti fusim në shërbim të Komunës së Vitisë. Te shëndetësia kemi 13430 shërbime të ndryshme shëndetësore, që janë 5000 euro dhe 13630 furnizime mjekësore. Aty ku kemi një

përqindje më të ulët. Te Drejtoria e Financave, dinamika e punëve që është në Drejtori të Financave dihet që aty janë të gjitha të lidhura me projektet dhe investimet kapitale. Tremujori i parë është fazë përgatitore dhe është fazë kur përgatitet dokumentacioni për tenderim, por atë që e kam cekur edhe vitin e kaluar jam edhe më optimist që këtë përqindjen që e patëm 97%, besoj se do ta rrisim, këto ishin anët pozitive. Sami ti the anët negative, por anë negative nuk ka.

znj.Majlinda Ostrogllava: Me të vërtetë vetëm për këtë periudhë të shpenzohen për mobilie 23 mijë euro, e derivate 7000 euro e dreka zyrtare 5000 euro, është një vlerë mjaft e madhe, duke pasur parasysh problemet e qytetarëve që ballafaqohen me shumë gjëra elementare. Për të mos i përsëritur edhe fjalët e kolegëve më herët, unë i kam tri pyetje konkrete për drejtorin e Financave. Të na jap një shpjegim pak më gjerësisht te pajisjet tjera, shërbimet e ndryshme shëndetësore dhe shërbimet kontraktuese tjera.

z.Bekim Azizi: Pikën e parë kryesues pata replikë me nënkryetarin, nuk ma dhe fjalën mos e prish një frymë të mirë që është në kuvend, ma lejon edhe rregullorja e kuvendit me marr fjalën dhe me replikuar sa herë që më përmendet emri, kisha bërë kërkesë mos e përsërit më të njëjtin gabim se jemi shumë afër, këtu mundem me dal të marr fjalën, mundem të flas edhe pa mikrofon, por të kisha bërë kështu kërkesë që respektoje momentin kur kemi ndonjë fjalë, kritikë me dhënë, sepse nuk bën mirë, mos e ashpërso debatin në Kuvend, sepse jemi munduar të respektojmë, edhe kur nuk na e ke dhënë fjalën nuk kemi bërë fjalë. Kisha bërë thirrje që mos e sjell punën që të ashpërsohet debati, por të jemi me një debat konstruktiv siç jemi duke diskutuar, na jepet mundësia edhe kur nuk i pranoni vërejtjet ti sqarojmë pse jo, sepse nënkryetari me injorancë zakonisht kur nuk i pëlqen ose kur ka shkelje ose kur nuk i bën mirë mundohet me një injorancë me ti dhënë përgjigjet, e prita mos po kthehet prapë edhe pse kalon pika unë tërë ditën jam, edhe kur nuk ma jep fjalën pikën tjetër unë prapë kyçem se ma të përlym sa që është bërë rruga e Tërpezës viran nuk mundet të jetë. Kryesues kur kam me diskutuar do të diskutoj. Fillim e diskutova atë nuk ma dhe fjalën për replikë, përderisa nuk ma dhe fjalën për replikë unë ti dhashë ato vërejtjet e mia, po sa do ta zgjas debatin ne e zgjasim nuk është problem, unë nuk i pritoj ditës, nuk i pritoj kohës, mua nuk më dhimbset koha, se unë nuk jam pjesë e pozitës, nuk jam pjesë e shkeljeve që i bëni ju dhe mua domethënë nuk më djegin ato shkeljet, këtu është problemi që ty të djegin dhe keni qejf me i tejkaluar, u krye, unë e pres nënkryetarin dhe diskutoj me të, por vetëm po të tregoj që për çështje tjera.

Te çështja e buxhetit po kyçem, shpenzimet e “Flakadanit të Karadakut”, kisha pas qejf ti di sa kanë kushtuar, sepse nuk kanë hyr në 3 mujorin e parë, besoj që na i jepni një sqarim. Nuk pash në raport që janë përmendur 27 mijë e 500 euro, që kanë qenë të planifikuara, që janë ndarë nga Qeveria për pagimin e dëmeve që përmes Kuvendit i kemi bartur në shpenzime kapitale për rregullim të lumit atje, ato nuk janë shpenzuar në vitin e kaluar, nuk i pash këtu në raport që janë paraqitur aty, besoj që na e jep një sqarim këtu. Te investimet kapitale gjatë 3-mujorit të parë janë shpenzuar 12 mijë euro, prej 1 milionë e 500 mijë të planifikuara janë 0.8% nuk janë 3.1% në llogaritje, nuk i keni mirë, shihet te planifikimi dhe te të hyrat që janë dhënë në 3-mujorin e parë, që në planifikim kemi ngecje, domethënë që nuk është bërë mirë planifikimi. Janë disa faktorë që shihen që ka në disa lëmi të hyra më mirë, mirëpo është 3-mujori i parë që në 3-mujorin e parë është problem pak se është fillimi i vitit, ndoshta të jepet një kahe shumë e përcaktuar e buxhetit, por besoj që 3-mujorët e tjerë do të jenë më të kompletuar. Shumicën e gjërave që pata me i diskutuar i potencoj Sameti dhe disa të tjerë.

z.Sami Demelezi. E tha edhe Aliu, po e them edhe unë, se është e vërtetë që në faqen e parë të dhëna inkurajuese edhe me të hyrat që janë në rritje në krahasim me vitin paraprak,

shifër e vogël vërtetë ndoshta për 9.27 %, por sido që të jetë ka një lëvizje shumë të mirë, apo mbi 14 mijë euro, por edhe për shpenzimet e buxhetit ka një lëvizje inkurajuese gjithashtu që është për tu përshëndetur. Ndoshta te investimet kapitale nuk ka lëvizje, mirëpo kur dihet e dhëna se gjatë prillit kemi përcjellë faqen zyrtare të komunës disa nga projektet veç janë dal për tenderim, atëherë shihet se vërtetë këtë vit ka një fillim më të mirë se sa vitin që e lamë pas. Unë kam disa vërejtje që në vazhdimësi po i kemi, e kam thënë edhe në KPF, po e them edhe këtu, se për mua është brengosëse fakti, pse për shembull këtu te e të tjera që po na përsëritet në shumë rubrika e kanë thënë zyrtarët, drejtori e ka thënë, por megjithatë unë konsideroj se ka dalje nga kjo situatë, sepse ne edhe shtetin e kam thënë se edhe në KPF edhe këtu po e them e kemi me fusnotë, prandaj pse të mos ketë fusnotë edhe këtu për sqarim që mos me na lodhur neve çdo herë me thënë çka këto të tjera, sepse vërtetë nuk po i dimë ne që nuk jemi ekonomistë, prandaj konsideroj se për herët tjerë mirë është që të bëhet një lëvizje në këtë aspekt. Dhe për të dal ka fundi edhe sa i përket donacioneve, ka një lëvizje inkurajuese që do të thotë deri në këtë periudhë të viti kaluar nuk kemi pasur asnjë donacion, tash sa do që është i vogël ky donacion, por megjithatë ka lëvizje dhe ka trende pozitive që është për inkurajim, mirëpo unë kisha porositur drejtorët e drejtorive që të mos ndalen në kërkim të donacioneve, sepse sa do që kërkojnë më shumë në këtë aspekt do të jenë më të suksesshëm, dhe fare në fund, shihet që është bërë një punë e mirë nga drejtoria në fjalë, me trende pozitive edhe për të hyrat edhe një dinamikë më e mirë në shpenzim, që çdo herë krahasuar me vitin paraprak do të thotë ka trende pozitive, mirëpo më shumë se me qenë i pari nuk ka ku shkon, se veç e kemi marr një raport që ashtu kështu, Komuna e Vitisë për shpenzim të buxhetit ka zënë vendin e parë, ne e dimë të gjithë që me qenë i pari është një ndjenjë e mirë për të gjithë ne, mirëpo mirë ka qenë që drejtori të kërkoj ndonjë shpërblim në qeveri, atje bile së paku tre vendet e para të shpërblehen me ndonjë projekt shtesë nga Qeveria, në mënyrë që komunat e tjera që të synojnë çdo herë vendin e parë.

znj.Selvije Rexhepi: Unë kisha me i përgëzuar zyrtarët e Drejtorisë së Financave për hartimin e pasqyrave financiare, mirëpo e kam një pyetje për drejtorin që edhe kur janë bërë pasqyrat në fund të vitit më ka ikur që ta bëj një pyetje te shërbimet kontraktuese. Kisha pyetur drejtorin: Çka janë aq shumë me rëndësi, që institucioni si institucion me gjithë atë numër të madh të stafit nuk po mundet me plotësuar?. Kisha dashur një listë, sepse në fund të vitit kanë qenë 67 mijë euro e më tepër kanë qenë shërbime të blera ose shërbime kontraktuese. Këtu i kemi 10 mijë e 973 euro, drejtor kisha dashur që ta kem një listë cilat janë ato shërbime dhe deri sa ka mundësi që këto shpërblime të blehen nga komuna, sepse unë e di që është një staf i mrekullueshëm që ka mundësi ti kryej edhe ato punë.

Kryesuesi: U parashtruan një numër pyetjesh, e ftoj drejtorin të jap përgjigje.

z.Ibrahim Rama: U parashtrua pyetja për shërbimet kontraktuese tjera, vlere prej 10 mijë e 973 euro, në këtë kod të shpenzimeve përveç pagesa e kontratave për shërbime të veçanta është një shumë edhe për punëtor të cilët paguhen edhe nga fondi i "Cros Border". Një prej pyetjeve të cilën shumë këshilltarë e potencuan, planifikimi apo inkasimi i të hyrave vetanake, vitin e kaluar kemi pasur një problem që ka qenë falja e borxheve, është një trend pozitiv tash, sepse jemi duke e bërë edhe një sensibilizim, që qytetarët të njoftohen se falja e borxheve do të përfundoj me 2 shtator. Planifikimi i të hyrave vetanake është i përcaktuar me kornizë afatmesme buxhetore nga niveli qendror, gjegjësisht nga Ministria e Financave. Burim kryesor i të hyrave vetanake është tatimi në pronë dhe regjistrimi i taksës së automjeteve.

Te shpërndarja e buxhetit nëpër drejtori, gjithmonë planifikohen të hyrat dhe shpenzimet dhe që votohet në Kuvend dhe aty ku ka diferenca në mes buxhetit të miratuar dhe shpenzimeve jemi të hapur të japim përgjigjësi. Pra, të hyrat vetanake jemi duke u munduar ti

realizojmë dhe besojmë që do ta arrijmë përqindjen që e kemi paraparë për këtë vit. Shpenzimet kapitale, është 3-mujori i parë që investimet kapitale nuk realizohen për shkak të fazave të projektimit, të tenderimit deri te ekzekutimi, kur fillon megjithatë bëjmë përpjekje maksimale, sepse kjo është kategori ekonomike që më së shumti i prek qytetarët. Një pyetje ishte për “Flakadani i Karadakut”, shpenzimet që kanë ndodhur i kemi faturat, por siç e dimë pasqyrat financiare paraqiten vetëm të dhënat e buxhetit të shpenzuar, ato fatura nuk janë paguar në 3-mujorin e parë. Pyetja tjetër nga Bekimi, subvencionet për ndihma të vërshimeve në vlerë prej 27 mijë e 500 euro, nuk është në pasqyra, sepse nuk janë paguar, sepse është vendimi në nivelin qendror, e kemi bërë një kërkesë për ridestinim të mjeteve dhe jemi duke e pritur vendimin e qeverisë për ta implementuar këtë vendim tuajin. Një pyetje ishte për kategorinë e shpenzimeve kodi 13460, në këtë kod përfshihen, ka pagesa vlera prej 5160 euro, është paga e punëtorëve të “cross border”, shuma tjera përfshin pagesa e punëtorit që ka shkuar pension të parakohshëm dhe vlera 5279 euro është pagesa për kontrata për shërbime të veçanta, kodi i shpenzimeve 13501 është fjala për furnizim me inventar e që e përbëjnë furnizimi me inventar për shkollën “Dëshmorët e Vitisë”, “Kuvendi i Lezhës”, furnizimi me mobilie në ambulancën në Pozheran dhe furnizimi me inventar zyra e projekteve. Kodi 13509, është fjala për shpenzimet e rregullimit dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik dhe pajisje tjera të materialit shpenzues që përdoret në të gjitha institucionet e Komunës së Vitisë. Kodi 13610, është fjala për furnizime për zyre që e përbëjnë furnizimi me material për zyre për të gjitha programet dhe për të gjitha drejtoritë, furnizime për zyre dhe reklama Zyra e Kryetari dhe furnizim për zyre për perde dhe tepisona në Drejtorinë e Arsimit dhe Shëndetësisë. Kodi 14020, është fjala për shpenzimet në mirëmbajtjen e ndërtesave dhe është një shërbim i kontaktuar.

z.Samet Idrizi: Drejtori ka harruar, faqe 25 nëse nuk jam gabim, kisha kërkuar edhe nga asamblistët të përqendrohen në faqe 25 dhe kisha dashur ti krahasoj dy periudha janar-mars 2015, janar-mars 2016 shpenzimet, këto shpenzimet e vitit 2015 kolona e tretë 13130, shpenzimet janë 2 mijë e 947 euro, 1710 euro janë për 2016, mirëpo obligimet po barten, obligimet në 2015 janë 3195 euro, këtu ose është harruar ndonjë faturë të paguhen, sepse nuk munden me qenë obligimet me të mëdha se shpenzimet, të lutem na jep sqarim. Tjetër, mos më keqkuptoni kur drejtori i lexon pasqyrat financiare nuk ka nevojë të dalin 3 asamblistë të LDK-së, sepse vetëm përzihen, sepse nuk dinë me i lexuar, sikur kur luan Ronaldo futboll e merr një futbollistë nga Kosova e shtin aty.

z.Ibrahim Rama: Këshilltarit, z.Sametit i kërkoj falje, sepse e paskam harruar pyetjen, në faqe 25 ku paraqitet krahasimi i shpenzimeve 2016 në krahasim me vitin 2015, kolona e vitit 2015 krahasohet me kolonën e vitit 2016, tash në kolonën e vitit 2015 shihet vetëm sa është paguar faturat që kanë arrit për me u paguar, domethënë pasqyrohet ekzekutimi, tash te shpenzimet e vitit 2016 që janë paguar, tregon pagesat që janë bërë për vitin 2015 dhe 2016, domethënë është krahasimi i pagesave.

Kryesuesi: Faleminderit për kontributin rreth kësaj pike të rendit të ditës.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi

3. Shqyrtimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 100.203 euro për përfundimin e projektit ndërtimi i sistemit të ujësjellësit në fshatrat Sllatinë e Epërme, Sllatinë e Poshtme, Sodovinë e Qerkezëve, Sodovinë e Jerlive dhe Trestenik të Komunës së Vitisë

E ftoj drejtorin të na e paraqes këtë propozim vendim.

z.Ibrahim Rama: Këto janë projekte që parashihen të realizohen në bashkëpunim me CDI, Ministrinë dhe Komunën e Vitisë. Këto projekte ndërlidhen me një borxh që është trashëguar,

borxhi që është konstatuar është një borxh që duhet ti paguhen CDI-së. Ligji parasheh mundësinë që në rast se një projekt ndeshet me një pamundësi për tu realizuar ose dalin punë shtesë, atëherë komuna mundet ta rris shumën e participimit në projekt. Atëherë esenca e këtij propozim vendimi është që të rritet shuma e participimit të komunës, me qëllim që të përfundohen këto projekte. Për pyetje, sqarime, vërejtje substanciale jam në dispozicionin tuaj.

Kryesuesi: Para se ta hapim debatin, e kërkoj fjalën nënkryetari.

z.Hasan Aliu: Unë kam qenë i përfshirë në këtë projekt sa i përket anës ligjore. Situata është që kanë kaluar dy vite e diçka dhe nuk ka mundur të lëviz procesi, dhe në bazë të marrëveshjes nëse dalin punë shtesë, atëherë ato duhet ti paguaj Komuna e Vitisë, atëherë nëse duam të bëjmë zgjidhje ne kemi shprehur gatishmërinë që të participojmë me këtë shumë prej 100.203 euro dhe kërkojmë mbështetjen e juaj që të votohet në Kuvend, me qëllim që të përfundohen këto projekte. Zgjidhje tjetër nuk kemi dhe kjo formë është konform ligjit.

Kryesuesi: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. Kush do ta merr fjalën?

znj.Mirlinda Sadiku: Kërkoj falje, po dal pak prej rendit të ditës, mirëpo kryesues, do të ishte mirë që pyetjet që i parashtrojmë të përgjigjen drejtorët. Me gjithë respektin, unë e di që z.Hasan i ka njohuritë ndoshta për çështje të caktuara, mirëpo për shembull na mbet përgjigja pa e marr nga drejtori i Arsimit, pikërisht pyetja që e bëri Bekimi, se në tender në faqen zyrtare të KRPP-se veç ka dal furnizim me rekuizita sportive e publikuar me 19.02.2016, mirëpo nuk morrem përgjigje pse nuk janë furnizuar shkollat me rekuizita sportive.

Sa i përket ujit, të gjithë e dimë që është një nevojë, është një domosdoshmëri. Drejtori e përmendi që zanafilla e këtij problemi është qysh në vitin 2012, mirëpo them me përgjegjësi të plotë se zanafilla e kronologjia e kësaj problematike është qysh më herët, për shembull e kemi ujësjellësin në fshatin Zhiti, ku sipas shkrimit të shkruar nga znj.Abide Osmani, të publikuar me 25.04.2016, Komisioni Evropian ka investuar diku rreth 400 mijë euro. Ky ujësjellës është jofunksional, e kemi ujësjellësin në fshatin Skifteraj, ku është investuar po ashtu nga Komisioni Evropian 450 mijë euro, nëse nuk gabohem viti 2005-2006, dhe prapë për 10 vite ky ujësjellës është jofunksional. Të njëjtën situatë e kemi edhe te ujësjellësi në Beguncë, ku sipas z.Dautit këtu janë investuar diku rreth 300 mijë euro, në bashkëpunim CDI me komunën, domethënë kronologjia e këtij problemi është bartur vit pas viti, domethënë qysh prej pas luftës për 15 vite me radhë të gjitha këto lokalitete i kanë ujësjellësit nëpër shtëpitë e veta, por nuk janë funksionale, për të ia shtuar edhe këtë gjë tjetër, ku për shembull lexohet lajmi që në Pozheran për 48 orë nuk do të ketë ujë, fshati Qifllag dhe Pozheran do të thotë të gjitha këto përgjegjësi, ose të mos flasim për gypat dhe rezervuarin që është në fshatin Shusht, atje kam shkruar vet e kam shikuar që diku janë gypat mbi tokë, rezervuari nuk është i siguar, gjithkush mundet të ketë qasje në atë rezervuar, mundet të rrezikohet shëndeti publik e prandaj një herë për të gjitha herët, gjithherë duke i referuar të gjitha këtyre shifrave milionëshe, duhet të gjendet një zgjidhje, të bëhet një adresë që ata njerëz, përsëmbull në këtë rast është “Hidro Morava”, kur tha edhe drejtori që të gjitha asetet i dorëzohen “Hidro Moravës”, të ketë adresë që edhe për ankesa të qytetarëve të kërkohej edhe cilësi prej tyre, sepse investon komuna. Ta zëmë tash që participon 100 mijë euro, nuk besoj që asnjë nga këshilltarët është kundër kësaj, por të jetë një adresë ku të kërkohej llogari prej saj kompanie qoftë për shërbim, qoftë për cilësi edhe kualitet e jo për shembull të jetë si Pozherani 48 orë pa ujë, plus cilësia e ujit të kontestohet, prandaj duhet të kihet parasysh. Absolut jam pro kësaj dhe shpresoj dhe besoj se do të bëhet zgjidhje edhe për ujësjellësin në Zhiti, Skifteraj dhe Beguncë e të hiqet njëherë e për të gjitha herët kjo problematikë.

z.Sami Demelezi: Pas sqarimeve që u dhanë për këtë propozim vendim, unë konsideroj se është një propozim vendim për tu përshëndetur, sepse çdo vonesë në këtë aspekt është e tepërt, dhe aq më tepër, kur dihet se ky borxh ka qenë një pengesë për investimet, gjegjësisht për donacionet, që kishte me i dhënë CDI, sa do që drejtori nuk po do ta fajësoj askënd, por dikush fajtor është, por nuk është në dorën tonë që ti dënojmë apo të ju japim lëvdata, kur është e udhës, mirëpo me i treguar dikujt që po di të lexoj, po di të marr me mend edhe atë se sa është dëmtuar komuna jonë për shkak të këtij borxhi. Dikush është fajtor, sa do të investonte a thua CDI në ndërkohë dhe ato po dimë të i mendojmë, se le që nuk po dimë me lexuar.

z.Sejdi Emini: Obligimet që i ka komuna duhet me i kryer sa më herët, se është më mirë të hapen rrugët. Këtu është një shumë bukur e konsiderueshme, që këta kanë shpresuar që ndokush ka me ua ndihmuar në ndonjë aspekt, por nuk ua ka ndihmuar, qytetarët ujin e kanë jetik, bile po mendoj që është vonuar kjo far pune, mirëpo unë kam një pyetje shumë konkrete që e kam bërë edhe më herët, disi po më duket po shkohet te punët prapë, jo mbarë në kohë të caktuar. Unë jam pro kësaj gjithsesi, sepse është interes jetik për qytetarët, është një projekt i tillë me CDI, që ka mbetur një borxh edhe për fshatrat tjerë, për fshatin Gërmovë dhe Goshicë. Unë e di që prej vitit 2009 është ai farë borxhi edhe po lihet anash, kështu që është mirë me iu qas punëve parimisht dhe me i kryer ashtu siç iu ka hije dhe ashtu siç e meritojnë. E dua një përgjigje: Pse nuk janë edhe ato fshatra pra?

z.Samet Idrizi: Unë personalisht kam qenë në komision vlerësimi të këtij projekti, që po flitet në Ferizaj CDI e ka pasur selinë, vlerësimi është bërë në vitin 2011, në 2012 kanë vazhduar punët, ka faj këtu edhe qeveria e kaluar edhe kjo qeveri bashkë me atë, mos të mundohet dikush të arsyetoj vetveten, viti i tretë është, unë e kam tërhequr vërejtjen shpesh, kam biseduar dhe kam thënë parat me kohë është dashur, aty kanë mund të ndahen parat në 2014, sidomos 2015 gjithsesi, dhe absolutisht nuk mundet të fajësohet CDI si organizatë implemetuese e Qeverisë Zvicerane, se ata nuk janë azhur në pagesat e veta, mos të mashtrohet dikush me thënë sepse ata janë 1 mijë vite para nesh. Ne e përkrahim absolutisht këtë dhe do ta votojmë si grup që këto 100 mijë e 203 euro për tu ndarë dhe për tu përmbyllur projekti. E përmendi fazën e pestë drejtori i financave që do të bëhen investime në të ardhmen.

z.Daut Xhemajli: Unë e shfrytëzoj rastin edhe njëherë lidhur me këtë çështje, të themi edhe diçka tjetër, e kemi thënë edhe në komitet edhe një prej mbledhjeve të para të komitetit kam kërkuar diçka lidhur me menaxhimin, mbikëqyrjen e projekteve që investon komuna, sidomos në ujësjellës dhe kanalizim. Komuna e ka jetike për tu angazhuar konform ligjeve në fuqi për ta bërë një kompani publike komunale dhe të mos drejtohet nga Gjilani, partneriteti publiko-privat “Eco Higjiena” e “Hidro Morava” etj. Këtë aspekt është obligim, është ligjore po shihet veç shpejtë e shpejtë i shënova të gjitha ato projekte që në Komunën e Vitisë janë realizuar, që nga pas lufta e kanë mbetur pa asnjë përkujdesje, duke filluar nga Skifteraj, Kabash, Binçë, Beguncë, Drobesh, Zhiti, Tërpezë, Radivojc, Sllatinë e Epërme, Lubishtë, Ramnishtë, Gërmovë, Goshicë, Fshat i Ri, Ramjan, kam harruar diçka tjetër ndoshta Mogilla etj, por me rëndësi është që këtu flitet për miliona investime që janë bërë në këto fshatra, në ujësjellës e kanalizim dhe pjesa dërrmuese e tyre është pa mbikëqyrje ose janë defekt, jashtë funksionit ose absolut askush nuk kujdeset për to, përveç ndonjë iniciativë e qytetarëve ose ndonjë këshilli të fshatit që ka mundur të bëjë një organizim sikur në Kabash dhe mbikëqyrja bëhet me pagesë nga një kompani private, por them se është momenti i fundit për këtë qeveri që të ndryshoj qasjen dhe mendoj që të gjitha ato të kaluarat të fillojnë të bien në binar. Nuk ka vepër, nuk ka projekt që funksionin pa mbikëqyrje, nuk ka vepër që funksionon pa

mirëmbajtje, sidomos ujësjellësit dhe kanalizimet. Problemi është që absolut me këtë 100 mijë euro ne e zhblllokojmë një proces, por me një formë nuk merremi me problematikën, ne i hapim rrugë investimeve tjera, ne e përfundojmë një punë, por në momentin që nuk e kemi këtë përgjegjësi komunale, ato vepra atje, këto miliona që i kemi investuar do të shkojnë sikur në fshatrat tjera. Pavarësisht se kam rezerva pse është bërë ky borxh, pse është vonuar, si është vonuar, si ka mundur të bëhet 100 mijë euro kjo vlerë, duke e pasur parasysh se CDI e qeveria kanë bërë marrëveshje, i kanë bërë paramasat, parallogaritë, projektet etj, nuk dua të kthehem prapa e as të kërkoj përgjegjësi në fund të fundit, sepse ne nuk jemi ai institucion që kërkojmë përgjegjësi dhe e dërgojmë deri në fund këtë punë, por këto mjete duhet ti ndajmë e të kujdesemi, sepse çdo marrëveshje, çdo investim që është bërë nga donatorët, Qeveria Zvicerane sidomos, por edhe Komisioni Evropian, kanë qenë nënshkrues së paku 3-4 palë edhe komuna, edhe donatori, edhe implementuesi, edhe ai që ka pasur të pranoj projektin në fund, edhe “Hidro Morava” edhe “Higjiena”, domethënë të gjithë përfaqësuesit e tyre i kanë nënshkrimet që kanë me pranuar projektin dhe kanë me u kujdesur për mbikëqyrje, asnjë them kushtimisht ndoshta me përjashtim tepër të vogël nuk janë përfunduar si duhet. Mirë kishte me qenë që kjo qeverisje të filloj të vë rend, se ne si Kuvend, si Qeveri kemi patjetër me investuar në të gjitha projektet që janë realizuar, që i përmenda, që kanë defekte, nuk ka kush investon tjetër, Komisionin Evropian nuk mund ta thërrasim më që të shkoj në Zhiti për të investuar ose në Skifteraj, ai nuk ka kohë për të na e bajt gajlen tonë. Zviceranët të japin mjete dhe të mbesin pa përkujdesje është turp për neve si institucion, prandaj për këtë nuk bisedohet që duhet të ndajmë patjetër, por përkujdesjen, pranimin e këtij projekti, duke e filluar pikërisht nga kjo, me procesverbal po ia japim fal këto asete atyre, megjithatë ata duhet me i thirr qytetar ma dhe nuk ka më të ujitet bahqja nga ujësjellësi, pa ujë matës etj, ose kanalizimin kujt ti teket e hap e derdh thesin e bërllokut, komuna nuk është adresa ta thërret qytetari është mbyllur kanalizimi, nuk po funksionon ujësjellësi, komuna ekzekutimin e punëve e ka dorëzuar te kompania dhe ne duhet të kërkojmë llogari nga ajo.

z.Bislim Bislimaj: Edhe unë desha të kyçem në këtë muhabet dhe ta jap kontributin tim në kuptim të përmasimit të kësaj gjendje, por gjithnjë në kritikë të asaj që ne shumë pak kemi bërë. Komuna Vitisë po më duket jemi të fundit për çdo gjë, në vend se të jemi të parët, sepse e kemi burimin e ujit të mjaftueshëm, të kthjellët si loti, dhe ti furnizojmë qytetarët tanë me ujë të pijshëm, ne gabimin e parë që e kemi bërë është me vonesën e investimit në kanalizime, edhe ato janë shumica janë përfunduar, por në mënyrë gjysmake dhe ato ndotje shkojnë në lumenj, kështu që përmes ujit nëntokësor vazhdon të përhapet ajo ndotje nëpër pusët nga e marrin qytetarët, kështu që ata në këtë mënyrë janë të atakuar nga sëmundje të ndryshme, e që vijnë si pasojë e pirjes së pesticideve, detergjenteve që derdhen në ato lumenj. Në anën tjetër e kemi edhe burimin e vetëm të Vitisë, se është burim i vazhdueshëm i kontaminimit me materie radioaktive, që vijnë si pasojë e gypit të azbestit, që e dimë që është erotik. Qysh para 10 viteve është dhënë urdhër që të largohen madje edhe pullazet e mbuluara me azbest, kurse ne vazhdojmë prapë ta kemi këtë. Këto projekte, edhe një kritikë e kisha bërë, në atë kuptimin që po me duket e kemi fituar mentalitetin që vetëm me anë të ndihmës së të huajve të kemi investime, por çka jemi ne atëherë, a jemi shtet apo koloni, nëse nuk kemi ne fondet e tona të veçanta për ujësjellës, për barna, atëherë ku është kuptimi i asaj që ne i themi vetes shtet. Ma merr mendja që ky do të jetë rasti i fundit që ne do të kërkojmë ndihmë prej tjerëve për këto raste të ujësjellësve nëpër fshatrat tona.

znj.Vjollca Kadolli-Halili: Sa i përket çështjes së këtij propozimi, seriozisht këta këshilltarët e opozitës po na kritikojnë që ne nuk po duam ta kritikojmë qeverinë aktuale, kemi mundësi edhe këtu me e kritikuar dhe dimë me kritikuar çka duhet, por qeverinë aktuale në këtë rast

duhet vetëm me e lavdëruar. Sa i përket çështjes që CDI, që Sameti e diskutoj, që ne po e kritikojmë edhe CDI-në, nuk është e vërtetë, se realisht unë pak a shumë kam qenë në ngjarje të kësaj marrëveshje, që ka qenë në 2011-2012, sepse CDI ka marrë edhe mjek nga QKMF, ka punuar në këtë drejtim që fshatarët ti njoftoj se si duhet të përdoret uji i pijes në ato vende, kemi qenë disa mjekë që kemi mbajtur ligjëratat nëpër ato fshatra, por nuk po e diskutojmë atë se si ka ardhur te kjo, se më veç po dihet fajtori, dimë të jemi kritikues dhe dimë shumë mirë me lexuar, mos u bëni merak për atë, por ne po e lavdërojmë prapë po e shfrytëzoj rastin me e lavdëruar kryetarin që ka marrë një vendim të tillë për ta zhblllokuar këtë gjendje që ka ndodhur që sa vite për ndarjen e mjeteve financiare për përfundimin e këtij projekti të ujësjellësit për 5 fshatra të Komunës së Vitisë, projekt që është filluar shumë vite më parë dhe shpresojmë që përfundimi i këtij projekti edhe si hap për implementimin edhe të projekteve tjera të ujësjellësit nëpër fshatra tjera dhe propozojmë që mjetet për këtë çështje të merren vetëm nga kodi për participim me donatorë.

z.Ali Bajrami: Unë do të ndërlidhem vetëm me këtë propozim vendim, që pas shumë përpjekjeve të kryetarit dhe drejtorit të Financave shumë takimeve që i kanë pasur me CDI, z.Astritin, më në fund është ardhur dhe është bërë një zgjidhje për debllokimin e sistemit të ujit për këto 5 fshatra, që kanë qenë për keqardhje, që kanë mbetur në një gjendje të tillë. Ky propozim vendim do të hap rrugë që me zhbllokimin e fazës së tretë, e aty të filloj edhe implementimi i fazës së katërt edhe i fazës së pestë dhe në një mënyrë ta rrumbullakojmë procesin sa i përket ujit në nivel të Komunës së Vitisë. Unë jam pro, do ta mbështes dhe gjithëherë ato propozim vendime që janë të mira dhe në shërbim të qytetarëve do ti mbështes fuqishëm.

Kryesuesi: Po konsideroj se e përfunduam debatin rreth kësaj pike të rendit të ditës, po e hedh në votim për miratim: Kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Konstatoj se me vota të të gjithëve miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katërt të rendit të ditës kemi

4. Propozim vendim për miratimin e planit komunal për efikasitet të energjisë 2016-2020

Ftoj drejtorin që në pika të shkurta të na jap sqarime rreth këtij propozim vendimi.

z.Nexhmedin Jakupi: Komuna jonë nuk e ka pasur një plan të tillë, i cili komunës i ka kushtuar 3200 euro. Ky plan është i bazuar në Ligjin mbi Energjinë, Ligjin mbi Efikasitetin e Energjisë, pastaj është edhe prej shumë rekomandimeve që ka dalë nga Zyra për Integrime Evropiane, që e obligon komunën që ta ketë zyrtarin për energji dhe efikasitet dhe ta ketë planin komunal për efikasitet të energjisë elektrike. Materialin e keni pranuar me kohë, për sqarime shtesë jam në dispozicionin tuaj.

Kryesuesi: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A do dikush ta merr fjalën?

z.Bekim Azizi. Me qenë se është plan nga një kompani, që e di që është bërë nga ekspertët, paraqet një lëmi që është e rëndësishme për zhvillimin e jetës, shfrytëzimi i energjisë ose efikasitetit. Në këtë plan mendoj se ka pas mundësi ose ka shumë gjëra që nuk paraqiten shumë qartë çka ne mundemi ne me bë, çka mundet të bëjë komuna, është plan i kushtueshëm, por është plan shumë i rëndësishëm, mendoj që duhet të përkrahet. Mendoj që duhet ti përmbahemi këtij plani, rekomandimet që janë mos të shkojmë më në ndriçim, të fillojmë ta bëjmë nëpër këto shtyllat që janë të vendosura, nëpër këto shtyllat e drurit vetëm një ndriçim me bë publik, por ti përmbahemi ndriçimit polar, pak me bërë një ndryshim që të jetë ai funksional, që të kemi një ndriçim që ti përmbahemi energjisë, efikasitetit e kështu me radhë. Te energjia kemi ende në zhvillim, domethënë kanë filluar edhe mos lejimin e mjeteve që lejojnë gazat që janë prodhime më të vjetra edhe nëpër vendbanime, ndërsa ne jemi shumë larg kësaj që statistikën e fundit japin, që mosha e mjeteve që shfrytëzohet që ndikon

drejtpërdrejt në energji është shumë e vjetër, është 17 vjet mesatarisht, që është një shqetësim, që ndikon drejtpërdrejt në shëndet dhe në energji. Do ta përkrahim këtë plan, mirëpo, kisha kërkuar që këtyre rekomandimeve ti përmbahemi dhe të zbatohet sa më shumë.

Kryesuesi: E hedhim në votim për miratim: Kush është për? Konstatohet se me vota të të gjithë të pranishmëve miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të fundit të rendit të ditës kemi

5. Propozim vendim për formimin e Komitetit për Barazi Gjinore

Nga OSBE është kërkuar që të formohet ky komitet, prandaj ne e kemi sjell si propozim vendim për formimin e këtij komiteti. Meqenëse komiteti do të ketë 5 anëtarë, unë kisha propozuar nga tri subjektet më të mëdha politike të na japin nga një emër të anëtarëve dhe një do të jetë përfaqësues nga shoqëria civile, mundësisht kemi vendosur që të jenë 4 femra dhe një mashkull, meqenëse kemi të bëjmë me barazi gjinore e këtë rast po e favorizojmë gjininë femërore. Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës.

znj.Vjollca Kadolli-Halili: Grupi i LDK-së e përkrah formimin e Komitetit për Barazi Gjinore dhe shpresojmë që ky komitet do të jetë si trup rekomandues pranë Kuvendit Komunal dhe do të ndihmoj në avancimin dhe realizimin në fushën e barazisë gjinore. Grupi i LDK-së propozon Ajtene Frangu si anëtare të këtij komiteti.

z.Samet Idrizi: PDK-ja e e favorizon Hyse Ramën, nuk është e përfshirë në asnjë komision.

z.Bislim Bislimi: Me që po flitet për komitet për barazi gjinore, unë jam kundër që të jenë 4 femra, por duhet të jenë të barabartë, propozoj që e gjithë kjo të bëhet në pajtim me ligjin.

z.Hasan Aliu: Fillimisht në rast se më lejohet, unë konsideroj se të gjitha komitetet të cilat formohen jashtë atyre obligative do ta ndihmojnë edhe ekzekutivin, do ti rekomandojnë ekzekutivit për punë mëtutjeshme komunale, prandaj unë konsideroj se në kuadër të ekzekutivit ne kemi zyre, por megjithatë një formim i një komiteti do të jetë edhe rekomandime, ndoshta do të dalin edhe shumë ide në çështjet të cilat do të shtrohen dhe nuk bëhet fjalë se ne po japim kahe të njëanshme, këtu bëhet fjalë për barazi gjinore, për të dy gjinitë, unë kisha dashur që të tri subjektet politike të ishin akorduar që ky numër të jetë 3 me 5, se edhe 4 me 1 mund të keqkuptohet. Unë konsideroj që të mos bëjmë diskriminim dhe të mos jenë të gjitha femra, por të ketë barazi të vërtetë gjinore me qëllim që të funksionoj me të vërtetë komiteti.

Kryesuesi: E pranojmë propozimin e Bislimit, i kemi dërguar 3 femra nga ana e Kuvendit, le të na e japin edhe nga një emër mashkull nga Kuvendi dhe shoqëria civile na e bie edhe një emër të gjinisë mashkullore dhe kështu formohet ky komitet. Unë propozoj që Vebiu të jetë nga këshilltarët e gjinisë mashkullore. Kush është që të miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës? Konstatohet se miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Ju falënderoj për kontributin e dhënë në këtë seancë!

Mirë u pafshim!

Mbledhja përfundoi me punë në ora 11 e 45 min.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12 e 30 min.

Procesmbajtës :
Ilir Zuka

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë
z.Naim Pira
